



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 20

Datë 28 shkurt 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 1/2014 datë 23.1.2014	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 119/2012, “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar”.....	415
Ligj nr. 4/2014 datë 30.1.2014	Për ratifikimin e konventës C187 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për kuadrin promocional të sigurisë dhe të shëndetit në punë”, 2006.....	415
Ligj nr. 5/2014 datë 30.1.2014	Për ratifikimin e konventës C167 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për sigurinë dhe shëndetin në ndërtim”, 1988.....	418
Ligj nr. 6/2014 datë 30.1.201	Për ratifikimin e “Traktatit për tregtinë e armëve”.....	425
Ligj nr. 7/2014 datë 30.1.2014	Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë.....	432

LIGJ
Nr. 1/2014

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME
FUQINË E LIGJIT, NR. 7, DATË 14.12.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA
NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 119/2012, “PËR
BUXHETIN E VITIT 2013”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 14.12.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 119/2012, “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar”.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 23.1.2014

LIGJ
Nr. 4/2014

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS C187 TË
ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS
(ILO) “PËR KUADRIN PROMOCIONAL TË
SIGURISË DHE TË SHËNDETIT NË
PUNË”, 2006**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa C187 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për kuadrin promociional të sigurisë dhe të shëndetit në punë”, 2006.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.1.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8497, datë 18.2.2014 të
Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

KONVENTA 187

**PËR KUADRIN PROMOCIONAL TË SIGURISË
DHE TË SHËNDETIT NË PUNË**

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

e mbledhur në Gjenevë nga organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe e mbledhur në sesionin e saj të nëntëdhjetepestë, më 31 maj 2006,

duke njohur rëndësinë e dëmtimeve, sëmundjeve dhe vdekjeve në punë, dhe nevojën për veprim të mëtejshëm për t'i pakësuar ato; dhe

duke rikujtuar se mbrojtja e punëtorëve ndaj sëmundjeve dhe dëmtimeve që rrjedhin nga punësimi përbën një ndër objektivat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, siç përcaktohet në Kushtetutën e saj; dhe

duke pranuar se dëmtimet, sëmundjet dhe vdekjet kanë ndikim negativ në produktivitetin dhe zhvillimin ekonomik social; dhe

duke vërejtur paragrafin III (g) të deklaratës së Filadelfias, që përcakton se Organizata Ndërkombëtare e Punës ka detyrimin solemn për të zhvilluar më tej midis kombeve të botës programet, të cilat do të arrijnë mbrojtje të përshtatshme për jetën dhe shëndetin e punëtorëve në të gjitha profesionet; dhe *të ndërgjegjshëm* për deklaratën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për parimet dhe të drejtat themelore në punë dhe ndjekjen e saj, 1998; dhe

duke vërejtur Konventën për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 1981 (nr. 155), Rekomandimin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 1981 (nr. 164), dhe instrumente të tjera të lidhura me kuadrin e nxitjes së sigurisë dhe shëndetit në punë; dhe

duke rikujtuar se nxitja e sigurisë dhe e shëndetit në punë është pjesë e programit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për punë të përshtatshme për të gjithë; dhe

duke rikujtuar konkluzionet në lidhje me aktivitetet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të lidhura me standardet në fushën e sigurisë dhe shëndetit - një strategji globale e miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës në sesionin e saj të 91-të (2003), në mënyrë të veçantë lidhur me garancinë që programet kombëtare do t'i japin përparësi sigurisë dhe shëndetit në punë; dhe

duke theksuar rëndësinë e nxitjes së vazhdueshme të kulturës kombëtare të parandalimit në funksion të sigurisë dhe të shëndetit; dhe

pasi ka vendosur për miratimin e disa propozimeve të dhëna në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë, që është pika e katërt në rendin e ditës së sesionit; dhe

pasi ka përcaktuar që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare,

miraton më 15 qershor 2006 Konventën e mëposhtme, e cila mund të citohet si Kuadri Mbështetës për Konventën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, 2006.

I. PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) Termi “politikë kombëtare” i referohet politikës kombëtare të sigurisë dhe të shëndetit në punë dhe mjedisit të punës të zhvilluar në përputhje me parimet e nenit 4 të Konventës së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, 1981 (nr. 155);

b) Termi “sistemi kombëtar i sigurisë dhe i shëndetit në punë” ose “sistemi kombëtar” i referohet infrastrukturës, e cila siguron kuadrin kryesor për zbatimin e politikës kombëtare dhe programeve kombëtare të sigurisë dhe shëndetit në punë;

c) Termi “programi kombëtar i sigurisë dhe i shëndetit” ose “programi kombëtar” i referohet çdo programi kombëtar që përfshin objektivat, të cilët duhen arritur në një kuadër kohor të paracaktuar, përparësitë dhe mjetet e veprimit të formuluar për të përmirësuar sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe mjetet për të vlerësuar progresin;

d) Termi “një kulturë kombëtare parandaluese për sigurinë dhe shëndetin” i referohet një kulture, në të cilën e drejta për mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm respektohet në të gjitha nivelet, ku qeveria, punëdhënësit dhe punëtorët marrin pjesë në mënyrë aktive në garantimin e një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm nëpërmjet një sistemi të drejtash, përgjegjësish dhe detyrash të përcaktuara, dhe ku parimi i parandalimit merr përparësinë më të lartë.

II. OBJEKTIVI

Neni 2

1. Çdo anëtar, i cili miraton këtë Konventë, mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë dhe shëndetit në punë për të parandaluar dëmtimet, sëmundjet dhe vdekjet në punë, me anë të zhvillimit të një politike kombëtare, sistemi kombëtar dhe të një programi kombëtar, në konsultim me organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve.

2. Çdo anëtar ndërmerr hapa aktivë në drejtim të arritjes në mënyrë progresive të një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm nëpërmjet një sistemi kombëtar dhe programesh kombëtare për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke marrë parasysh parimet e përcaktuara në instrumentet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) që lidhen me kuadrin mbështetës për sigurinë dhe shëndetin në punë.

3. Çdo anëtar shqyrton në mënyrë periodike dhe në konsultim me organizatat më përfaqësuese, të

punëdhënësve dhe të punëtorëve se çfarë masash mund të ndërmerren për të miratuar konventat përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për Sigurinë dhe Shëndetin.

III. POLITIKA KOMBËTARE

Neni 3

1. Çdo anëtar mbështet një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm me anë të hartimit të një politike kombëtare.

2. Çdo anëtar mbështet paraprakisht, në të gjitha nivelet përkatëse, të drejtën e punëtorëve për një mjedis pune të sigurt e të shëndetshëm.

3. Gjatë hartimit të kësaj politike, çdo anëtar, duke marrë parasysh kushtet dhe praktikën kombëtare, dhe në konsultim me organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve, mbështet parimet bazë, të tilla si: vlerësimi i risqeve ose i rreziqeve në punë; luftimi i risqeve ose i rreziqeve në punë që në burim; dhe zhvillimi i kulturës kombëtare parandaluese për sigurinë dhe shëndetin që përfshin informimin, konsultimin dhe trajnimin.

IV. SISTEMI KOMBËTAR

Neni 4

1. Çdo anëtar krijon, ruan, zhvillon në mënyrë progresive dhe shqyrton në mënyrë periodike sistemin kombëtar të sigurisë dhe të shëndetit në punë, në konsultim me organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punëtorëve.

2. Sistemi kombëtar i sigurisë dhe i shëndetit në punë duhet të përfshijë, ndër të tjera:

a) aktet ligjore dhe aktet nënligjore, marrëveshjet kolektive, kur është e përshtatshme, dhe çdo instrument tjetër përkatës në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë;

b) një autoritet apo organ, apo autoritete dhe organe, përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë, të emëruara në përputhje me të drejtën dhe praktikën kombëtare;

c) mekanizma për të garantuar respektimin e akteve ligjore dhe nënligjore kombëtare, duke përfshirë sistemin e inspektimit; dhe

d) masat për të mbështetur, në nivel sipërmarrje, bashkëpunimin ndërmjet drejtimit, punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre, si element thelbësor i lidhur me masat parandaluese në vendin e punës.

3. Sistemi kombëtar për sigurinë dhe shëndetin në punë duhet të përfshijë, kur është e përshtatshme:

a) një organ apo organe këshillimi tripalëshe që trajtojnë çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë;

b) shërbime informimi dhe këshillimi për sigurinë dhe shëndetin në punë;

c) sigurimi i trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë;

d) shërbimet e shëndetit në përputhje me të drejtën dhe praktikën kombëtare;

e) kërkimi në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë;

f) një mekanizëm për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për dëmtimet dhe sëmundjet në punë, duke marrë parasysh të gjitha instrumentet përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Punës;

g) dispozita për bashkëpunimin me skemat përkatëse të sigurimeve apo sociale që mbulojnë dëmtimet dhe sëmundjet në punë; dhe

h) mekanizma mbështetës për një përmirësim progresiv të kushteve të sigurisë dhe të shëndetit në punë në ndërmarrjet mikro, në ndërmarrjet e vogla e të mesme dhe në ekonominë informale.

V. PROGRAMI KOMBËTAR

Neni 5

1. Çdo anëtar formulon, zbaton, monitoron, vlerëson dhe rishikon në mënyrë periodike një program kombëtar për sigurinë dhe shëndetin në punë, në konsultim me organizatat më përfaqësuese të punëdhënëseve dhe punëtorëve.

2. Programi kombëtar:

a) mbështet zhvillimin e kulturës kombëtare parandaluese për sigurinë dhe shëndetin;

b) kontribuon për mbrojtjen e punëtorëve me anë të eliminimit ose minimizimit, aq sa është praktikisht e arsyeshme, të rreziqeve dhe risqeve që lidhen me punën, në përputhje me të drejtën dhe praktikën kombëtare, me qëllim që të shmangë dëmtimet, sëmundjet dhe vdekjet në punë dhe të mbështesë sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës;

c) formulohet dhe rishikohet në bazë të analizës së situatës kombëtare në lidhje me sigurinë dhe shëndetin, duke përfshirë analizën e sistemit kombëtar për sigurinë dhe shëndetin në punë;

d) përfshin objektivat, synimet dhe treguesit e progresit; dhe

e) mbështetet, ku është e mundur, nga programe dhe plane kombëtare të tjera shtesë, të cilat do të ndihmojnë në arritjen në mënyrë progresive të një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm.

3. Programi kombëtar publikohet gjerësisht dhe, në atë masë që është e mundur, miratohet dhe shpallet nga autoritetet më të larta kombëtare.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 6

Kjo Konventë nuk rishikon asnjë konventë apo rekomandim ndërkombëtar të punës.

Neni 7

Drejtori i përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njoftohet për miratimet zyrtare të kësaj Konvente për regjistrim.

Neni 8

1. Kjo Konventë është detyruese vetëm për ata anëtarë të Organizatës Botërore të Punës, miratimet e të cilëve janë regjistruar pranë drejtorit të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

2. Ajo hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën janë regjistruar pranë drejtorit të përgjithshëm miratimet e dy anëtarëve.

3. Pas kësaj, kjo kontratë hyn në fuqi për çdo anëtar dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën është regjistruar miratimi i tij.

Neni 9

1. Anëtarë, i cili ka miratuar këtë Konventë, mund ta denoncojë atë pas kalimit të një periudhe prej dhjetë vitesh nga data në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi për herë të parë, me anë të një akti që i komunikohet drejtorit të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Një denoncim i tillë nuk hyn në fuqi për një periudhë kohore deri një vit pas datës në të cilën është regjistruar.

2. Çdo anëtar që ka miratuar këtë Konventë dhe që, brenda vitit pas mbarimit të periudhës dhjetëvjeçare, të përmendur në paragrafin pararendës, nuk ushtron të drejtën e denoncimit të parashikuar në këtë nen, do t'i nënshtrohet Konventës për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe, për rrjedhojë, mund ta denoncojë këtë Konventë në përfundim të çdo periudhe prej dhjetë vjetësh në bazë të kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 10

1. Drejtori i përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha miratimeve dhe denoncimeve që u janë komunikuar nga anëtarët e organizatës.

2. Kur njofton anëtarët e Organizatës për regjistrimin e miratimit të dytë që i është komunikuar, drejtori i përgjithshëm u tërheq vëmendjen anëtarëve të organizatës për datën në të cilën hyn në fuqi Konventa.

Neni 11

Drejtori i përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton sekretarin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrimin në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, detajet e plota të të gjitha miratimeve dhe akteve të denoncimit që janë regjistruar.

Neni 12

Në ato raste që mund ta çmojë të nevojshme, organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës i paraqet konferencës së përgjithshme një raport për funksionimin e kësaj Konvente dhe shqyrton dëshirën e vendosjes së rishikimit të pjesëshëm apo të plotë të saj në rendin e ditës së Konferencës.

Neni 13

1. Nëse Konferenca miraton një Konventë që rishikon këtë Konventë tërësisht ose pjesërisht, atëherë, nëse Konventa e re nuk parashikon ndryshe:

a) miratimi nga një anëtar i Konventës së re rishikuese përfshin *ipso jure* denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, pavarësisht nenit 9 më sipër, nëse, dhe kur të hyjë në fuqi Konventa e re;

b) në datën kur hyn në fuqi Konventa e re rishikuese, kjo Konventë nuk është më e hapur për miratim nga anëtarët.

2. Kjo Konventë mbetet në çdo rast në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj faktike për ata anëtarë që e kanë miratuar atë, por që nuk kanë miratuar Konventën rishikuese.

Neni 14

Versionet në gjuhën angleze dhe frënge të tekstit të kësaj Konvente kanë fuqi të njëjtë.

LIGJ

Nr. 5/2014

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS C167 TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS (ILO) "PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË NDËRTIM", 1988

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa C167 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) "Për sigurinë dhe shëndetin në ndërtim", 1988.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.1.2014

Shpallur me dekretin nr. 8498, datë 18.2.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

KONVENTA 167

SIGURIA DHE SHËNDETI NË NDËRTIM

Konferenca e përgjithshme e Organizatës Botërore të Punës,

e mbledhur në Gjenevë nga organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, dhe e mbledhur në sesionin e shtatëdhjetepestë, më 1 qershor 1988; dhe

duke marrë parasysh konventat dhe rekomandimet e rëndësishme ndërkombëtare të punës e në mënyrë të veçantë, Konventën dhe Rekomandimin e Rregullave të Sigurisë (në Ndërtim), 1937, dhe rekomandimet e bashkëpunimit për parandalimin e aksidenteve (në ndërtim), 1937, Konventën dhe rekomandimet e mbrojtjes nga rrezatimi, 1960, Konventën dhe Rekomandimin e Ruajtjes së Makinerive, 1963, Konventën dhe Rekomandimin e Peshës Maksimale, 1967, Konventën dhe Rekomandimin e Mbrojtjes nga Kanceri në Punë, 1974, Konventa dhe Rekomandimi për Mjedisin e Punës (ndotja e ajrit, zhurma dhe dridhjet), 1977, Konventa dhe Rekomandimi për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 1981, Konventa dhe Rekomandimi për Shërbimet e Shëndetit në Punë, 1985, Konventa dhe Rekomandimi për Asbestin, 1986, dhe listën e sëmundjeve profesionale të rishikuar në vitin 1980 dhe bashkëlidhur Konventës së Përfitimeve të Dëmtimeve të Punësimit, 1964; dhe

duke marrë vendim në bazë të miratimit të propozimeve të caktuara në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në ndërtim, që është pika e katërt e rendit të ditës së sesionit; dhe

duke përcaktuar se këto propozime marrin formën e një konvente ndërkombëtare që rishikon Konventën e Rregullave të Sigurisë (në Ndërtim), 1937,

miraton më 20 qershor 1988 Konventën e mëposhtme, e cila mund të citohet Konventa e Sigurisë dhe Shëndetit në Ndërtim, 1988:

I. OBJEKTI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

1. Kjo Konventë zbatohet për të gjitha veprimtaritë ndërtuese, përkatësisht në ndërtim, vepra inxhinierike, dhe në veprat e ngritjes dhe të çmontimit, duke përfshirë çfarëdo procesi, operacioni apo transporti në një kantier ndërtimi, nga përgatitja e kantierit deri në përfundimin e projektit.

2. Anëtarë që miraton këtë Konventë, pas konsultimit me organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punëtorëve në fjalë, kur ato ekzistojnë, mund të përjashtojë nga zbatimi i Konventës apo nga dispozita të saj, degë të veçanta të veprimtarisë ekonomike apo ndërmarrjeve të veçanta në funksion të të cilave lindin probleme të një natyre thelbësore, me kusht që të ruhet një mjedis pune i sigurt dhe i shëndetshëm.

3. Kjo Konventë zbatohet edhe për persona të vetëpunësuar, siç mund të përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare.

Neni 2

Për qëllimin e kësaj Konvente:

a) Termi “ndërtim” mbulon:

i) ndërtimin, duke përfshirë gërmimin dhe konstruksionin, ndryshimin strukturor, rinovimin, riparimin, mirëmbajtjen (duke përfshirë pastrimin dhe lysterjen) dhe shembjen e të gjitha llojeve të ndërtesave apo strukturate;

ii) vepra inxhinierike, duke përfshirë gërmimin, ndryshimin strukturor, riparimin, mirëmbajtjen dhe shembjen, për shembull: të aeroporteve, kantierëve detare, porteve, rrugëve të brendshme ujore, digave, veprave mbrojtëse të lumenjve, ortekëve dhe deteve, rrugëve dhe hekurudhave, urave, tuneleve, viadukteve dhe veprave që lidhen me ofrimin e shërbimeve, të tilla si: komunikimi, kullimi, ujërat e zeza, uji dhe furnizimet me energji;

iii) ngritja dhe çmontimi i ndërtesave parafabrikate, si dhe prodhimi i elementeve të parafabikuara në kantierin e ndërtimit.

b) Termi “kantier ndërtimi” nënkupton çdo kantier në të cilin realizohen proceset ose veprimtaritë e përshkruara në nënparagrafin “a” më sipër;

c) Termi “vendi i punës” nënkupton të gjitha vendet ku punëtorët duhet të jenë ose të shkojnë për shkak të punës së tyre dhe që janë nën kontrollin e një punëdhënësi, siç përcaktohet në nënparagrafin “e” më poshtë.

d) Termi “punëtor” nënkupton çdo person të angazhuar në ndërtim.

e) Termi “punëdhënës” nënkupton:

i) çdo person fizik apo juridik që punëson një ose më shumë punëtorë në një kantier ndërtimi; dhe

ii) sipas kontekstit, kontraktorin kryesor apo nënkontraktorin.

f) Termi “person kompetent” nënkupton një person që zotëron kualifikime të mjaftueshme, të tilla si: trajnimi i përshtatshëm dhe njohuritë e mjaftueshme, përvoja dhe aftësitë për kryerjen e sigurt të punës specifike. Autoritetet kompetente mund të përcaktojnë kriteret e përshtatshme për caktimin e personave të tillë dhe mund të përcaktojnë detyrat që u caktohen atyre.

g) Termi “skela” nënkupton çdo strukturë të përkohshme, të fiksuar, të varur apo të lëvizshme dhe komponentët e saj mbështetës, e cila përdoret për mbajtjen e punëtorëve dhe materialeve ose për të fituar akses ndaj strukturave të tilla dhe që nuk është një “pajisje ngritëse”, siç përcaktohet në nënparagrafin “h” më poshtë.

h) Termi “pajisje ngritëse” nënkupton çdo pajisje të palëvizshme ose të lëvizshme që përdoret për ngritjen ose uljen e personave dhe të ngarkesave.

i) Termi “mekanizëm ngritës” nënkupton çdo mekanizëm apo mjet ngritës me anë të të cilit një ngarkesë mund t’i bashkëngjitet një pajisjeje ngritëse, por që nuk formon pjesë integrale të pajisjes apo të ngarkesës.

II. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 3

Organizatave të përfaqësuese të organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve në fjalë konsultohen për masat që duhet të ndërmerren në lidhje me zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente.

Neni 4

Çdo anëtar që miraton këtë Konventë merr përsipër që, në bazë të vlerësimit të rreziqeve të përfshira të sigurisë dhe të shëndetit, ai do të miratojë dhe të mbajë në fuqi aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat garantojnë zbatimin e dispozitave të Konventës.

Neni 5

1. Aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara në zbatim të nenit 4 më sipër mund të sigurojnë zbatimin e tyre praktik me anë të standardeve teknike ose kodeve të praktikës, ose me anë të metodave të tjera të përshtatshme në përputhje me kushtet dhe praktikatat kombëtare.

2. Për zbatimin e nenit 4 më sipër dhe paragrafit 1 të këtij neni, çdo anëtar merr parasysh, sipas rregullit, standardet e rëndësishme të miratuara nga organizatat e njohura ndërkombëtare në fushën e standardizimit.

Neni 6

Masat merren për të garantuar që ekziston bashkëpunimi ndërmjet punëdhënësve dhe punëtorëve, në përputhje me masat që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare, me qëllim që të nxitet siguria dhe shëndeti në kantieret e ndërtimit.

Neni 7

Aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare kërkojnë që punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar të kenë detyrë respektimin e masave të përcaktuara të sigurisë dhe të shëndetit në vendin e punës.

Neni 8

1. Kurdoherë që dy ose më shumë punëdhënës ndërmarrin aktivitete në mënyrë të njëkohshme në një kantier ndërtimi:

a) Kontraktori kryesor ose personi apo organi tjetër që ka kontroll faktik ose përgjegjësinë kryesore për veprimtarinë e përgjithshme të kantierit të ndërtimit, është përgjegjës për koordinimin e masave të përcaktuara të sigurisë dhe shëndetit, dhe deri në atë masë që është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare, për garantimin e respektimit të masave të tilla;

b) Aq sa është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare, kur kontraktori kryesor ose personi apo organi tjetër që ka kontroll faktik ose përgjegjësinë kryesore për veprimtarinë e përgjithshme të kantierit të ndërtimit, nuk është i pranishëm në kantier, ai emëron një person apo organ kompetent në kantier me kompetencat dhe mjetet e nevojshme për të siguruar në emër të tij koordinimin dhe respektimin e masave të parashikuara në nënparagrafin “a” më sipër;

c) Secili punëdhënës mbetet përgjegjës për zbatimin e masave të përcaktuara në lidhje me punëtorët e vendosur nën autoritetin e tij.

2. Kurdoherë që punëdhënësit ose personat e vetëpunësuar ndërmarrin veprimtari të njëkohshme në një kantier ndërtimi, ata kanë detyrë të bashkëpunojnë në zbatimin e masave të sigurisë dhe të shëndetit, siç mund të jenë të specifikuar nga aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare.

Neni 9

Ata që merren me projektimin dhe planifikimin e një projekti ndërtimi, marrin parasysh sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve të ndërtimit, në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe praktikatat kombëtare.

Neni 10

Aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare garantojnë që punëtorët kanë të drejtë dhe detyrë në çdo vend pune të marrin pjesë në garantimin e kushteve të sigurta të punës në atë masë që kanë kontrollin e tyre mbi pajisjet dhe metodat e punës dhe të shprehin mendime mbi procedurat e miratuara të punës, kur ato mund të prekin sigurinë dhe shëndetin.

Neni 11

Aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare garantojnë që punëtorët të kenë detyrat e mëposhtme:

a) të bashkëpunojnë sa më ngushtë që të jetë e mundur me punëdhënësin e tyre për zbatimin e masave të përcaktuara të sigurisë dhe të shëndetit;

b) të tregojnë kujdes të arsyeshëm për sigurinë dhe shëndetin e tyre dhe të personave të tjerë që mund të preken nga veprimet ose mosveprimet e tyre në punë;

c) të përdorin mjediset e vëna në dispozicion dhe të mos shpërdorojnë asgjë që është dhënë për mbrojtjen e tyre apo për mbrojtjen e të tjerëve;

d) të raportojnë menjëherë pranë mbikëqyrësit të tyre të drejtpërdrejtë dhe pranë përfaqësuesit të sigurisë së punëtorëve, aty ku ekziston, çdo situatë, për të cilën ata besojnë se mund të paraqesë rrezik, dhe të cilën ata nuk mund ta vetëmenaxhojnë siç duhet;

e) të respektojnë masat e përcaktuara të sigurisë dhe të shëndetit.

Neni 12

1. Aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare garantojnë se punëtori ka të drejtë të eliminojë rrezikun, kur ai ka arsye të fortë për të besuar që ekziston një rrezik i afërt dhe serioz ndaj sigurisë ose shëndetit të tij, dhe ka detyrë rrjedhimisht të informojë menjëherë mbikëqyrësin e tij.

2. Kur ekziston një rrezik i afërt për sigurinë e punëtorëve, punëdhënësi merr hapa të menjëhershëm për të ndaluar operacionin dhe për të evakuuar punëtorët siç kërkohet.

III. MASAT PARANDALUESE DHE MBROJTËSE

Neni 13

Siguria e vendit të punës

1. Merren të gjitha masat paraprake për të siguruar që të gjitha vendet e punës të jenë të sigurta dhe pa rrezik dëmtimi ndaj sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve.

2. Sigurohen, ruhen dhe tregohen, kur është e përshtatshme, mjete të sigurisë për hyrjen dhe daljen nga vendet e punës.

3. Merren të gjitha masat paraprake për mbrojtjen e personave që janë të pranishëm brenda ose afër një kantieri ndërtimi, ndaj të gjitha rreziqeve që mund të lindin nga një kantier i tillë.

Neni 14

Skelat dhe shkallët

1. Në rastet kur puna nuk mund të realizohet në mënyrë të sigurt në tokë ose mbi tokë, apo nga një pjesë e ndërtesës, apo strukturë tjetër e përhershme, sigurohet dhe mbahet një skelë e përshtatshme, ose ofrohet një zgjidhje e përshtatshme po aq e sigurt.

2. Në mungesë të mjeteve alternative të sigurta të hyrjes në vendet e punës në lartësi, sigurohen shkallë të përshtatshme dhe të forta. Ato duhet të sigurohen sipas rregullave ndaj lëvizjes së pakujdesshme.

3. Të gjitha skelat dhe shkallët ndërtohen dhe përdoren në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare.

4. Skelat inspektohen nga një person kompetent në raste dhe momente të tilla, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare.

Neni 15

Pajisjet dhe mekanizmat ngritës

1. Çdo pajisje ngritëse dhe element i mekanizmit ngritës, duke përfshirë dhe elementet e tyre përbërëse: lidhëset, kapëset dhe mbështetëset, duhet:

a) të kenë projektim dhe konstruksion të mirë, material të fortë dhe forcë të mjaftueshme për qëllimin që ato përdoren;

b) të instalohen dhe të përdoren siç kërkohet;

c) të mbahen në gjendje të mirë pune;

d) të kontrollohen dhe të provohen nga një person kompetent në atë kohë dhe në ato raste që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare; rezultatet e këtyre kontrolleve dhe provave regjistrohen;

e) të operohen nga punëtorë që kanë marrë trajnimin e duhur, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare.

2. Asnjë person nuk do të ngrihet, ulet apo transportohet nga një pajisje ngritëse, nëse ajo nuk është konstruktuar, instaluar dhe përdorur për atë qëllim në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare, përveç rasteve të një situatë emergjente në të cilën mund të ndodhin plagosje serioze ose vdekje dhe për të cilën pajisja ngritëse mund të përdoret në mënyrë të sigurt.

Neni 16

Transporti, mjetet e lëvizjes së dheut dhe të manovrimit të materialeve

1. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e lëvizjes së dheut ose të manovrimit të materialeve duhet:

a) të kenë projektim dhe konstruksion të mirë, duke marrë parasysh aq sa është e mundur, parimet ergonomike;

b) të mbahen në gjendje të mirë pune;

c) të përdoren në mënyrë të përshtatshme;

d) të përdoren nga punëtorë që kanë marrë trajnimin e duhur në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare.

2. Në të gjitha kantieret e ndërtimit ku përdoren mjetet, pajisjet e lëvizjes së dheut apo manovrimit të materialeve duhet:

a) të sigurohen rrugë hyrëse të sigurta e të përshtatshme për to; dhe

b) që qarkullimi të organizohet dhe të kontrollohet në mënyrë të tillë që të sigurojë funksionimin e tyre të sigurt.

Neni 17

Impiantet, makineritë, pajisjet dhe mjetet e dorës

1. Impiantet, makineritë dhe pajisjet, duke përfshirë mjetet e dorës, si ato që vihen në lëvizje me dorë, ashtu edhe ato që vihen në lëvizje me energji, duhet:

a) të kenë projektim dhe konstruksion të mirë, duke marrë parasysh aq sa është e mundur parimet ergonomike;

b) të mbahen në gjendje të mirë pune;

c) të përdoren vetëm për ato punë për të cilat janë projektuar dhe për punë të tjera jashtë qëllimeve fillestare të projektimit, vetëm nëse është dhënë vlerësim nga një person kompetent, i cili ka arritur në përfundimin se një përdorim i tillë është i sigurt;

d) të përdoren nga punëtorë që kanë marrë trajnimin e duhur.

2. Prodhuesi ose punëdhënësi sigurojnë në një formë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesit udhëzimet e plota, kur është e nevojshme, në lidhje me përdorimin e sigurt.

3. Impianti dhe pajisjet e presionit shqyrtohen dhe testohen nga një person kompetent sipas rasteve dhe në kohën që përshkruhen në aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare.

Neni 18

Puna në lartësi, duke përfshirë punën në çati

1. Kur është e nevojshme për t'u ruajtur nga rreziku ose kur lartësia e një strukture apo pjerrtësia e saj kalon atë që përshkruhet nga aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare, atëherë merren masa kundër rënies së punëtorëve, si dhe të mjeteve apo objekteve dhe materialeve të tjera.

2. Kur punëtorëve u kërkohet të punojnë në çati apo afër tyre, apo në vende të tjera të mbuluara me materiale të thyeshme nga të cilat rrezikojnë të bien, atëherë merren masa kundër shkeljes së pakujdesshme mbi materialin e thyeshëm apo rënies për shkak të tij.

Neni 19

Gërmimet, shpimet, punimet e dheut, punimet nëntokësore dhe tunelet

Gjatë gërmimeve, shpimeve, punimeve të dheut, punimeve nëntokësore dhe tuneleve duhen marrë masa parandaluese të mjaftueshme, si më poshtë:

a) vënien e mbajtëseve të përshtatshme për të mbrojtur punëtorët nga të gjitha zhvendosjet e dheut, gurëve dhe materialeve të tjera;

b) sigurimin e mbrojtjes kundër rreziqeve që vijnë nga rënia e personave, materialeve, objekteve apo vërshimi i ujit në gërmime, shpime, punimet e dheut, punimet nëntokësore ose tunele;

c) sigurimin e ventilimit të bollshëm në çdo vend pune, në mënyrë që të ruhet një atmosferë e përshtatshme për frymëmarrje dhe për të kufizuar tymrat, gazrat, avujt, pluhurat dhe papastërtitë e tjera në nivele që nuk janë të rrezikshme apo dëmtoese për shëndetin dhe që janë brenda kufijve të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare;

d) mundësimin për punëtorët që të kenë siguri në rast zjarri ose në rast vërshimi të ujit apo materialit;

e) shmangien e rrezikut për punëtorët, që lind nga rreziqet e mundshme nëntokësore, siç janë qarkullimi i lëngjeve apo prania e xhepave të gazit, duke ndërmarrë hetimin e duhur për t'i lokalizuar ato.

Neni 20

Armaturat e brendshme dhe kesonët

1. Të gjitha armaturat e brendshme dhe kesonët:

a) duhet të kenë konstruksion të mirë e të përshtatshëm dhe të jenë prej materiali të mirë dhe mjaftueshmërisht të fortë;

b) të pajisen me mjetet e nevojshme për punëtorët, në mënyrë që ata të jenë të sigurt në rast vërshimi të ujit apo të materialit.

2. Ndërtimi, pozicionimi, modifikimi ose çmontimi i armaturave të brendshme dhe kesonëve duhet të bëhet vetëm nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të një personi kompetent.

3. Të gjitha armaturat e brendshme dhe kesonët duhet të inspektohen nga një person kompetent në bazë të intervaleve të përcaktuara.

Neni 21

Puna në ajër të ngjeshur

1. Puna në ajër të ngjeshur duhet të realizohet vetëm në përputhje me masat e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare.

2. Puna në ajër të ngjeshur duhet të realizohet vetëm nga punëtorë, aftësia fizike e të cilëve për një punë të tillë është përcaktuar nëpërmjet një vizite mjekësore dhe kur është i pranishëm një person kompetent për të mbikëqyrur realizimin e operacioneve.

Neni 22

Kornizat strukturore dhe armaturat

1. Ndërtimi i kornizave dhe i komponentëve strukturorë, armaturat, armaturat harkore dhe armaturat mbështetëse duhet të realizohet vetëm nën mbikëqyrjen e personit kompetent.

2. Duhet marrë masa parandaluese të plota për të ruajtur punëtorët nga rreziqet që vijnë nga gjendja e përkohshme e dobët apo paqëndrueshmëria e strukturës.

3. Armaturat, armaturat harkore dhe armaturat mbështetëse duhen projektuar, ndërtuar dhe ruajtur në atë mënyrë që të mbajnë në mënyrë të sigurt të gjitha ngarkesat që mund të vendosen mbi to.

Neni 23

Puna mbi ujë

Kur puna kryhet mbi ujë ose fare pranë ujit, merren masat e mjaftueshme për:

a) parandalimin e rënies së punëtorëve në ujë;

b) shpëtimin e punëtorëve në rrezik mbytjeje;

c) transport të sigurt dhe të mjaftueshëm.

Neni 24

Shembja

Në rastet kur shembja e ndërtesave apo e strukturave mund të paraqesë rrezik për punëtorët apo për publikun:

a) miratohen masat, metodat dhe procedurat e përshtatshme, duke përfshirë ato për largimin e mbeturinave apo mbetjeve në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare;

b) puna planifikohet dhe ndërmerret vetëm nën mbikëqyrjen e personit kompetent.

Neni 25

Ndriçimi

Në çdo vend pune dhe çdo vend tjetër në kantierin e ndërtimit, kur punëtorëve mund t'u duhet të kalojnë, sigurohet ndriçim i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, duke përfshirë ndriçimin e lëvizshëm, kur është e përshtatshme.

Neni 26

Energjia

1. Të gjitha pajisjet dhe instalimet elektrike ndërtohen, instalohen dhe mirëmbahen nga një person kompetent dhe përdoren në mënyrë të tillë që të sigurojnë mbrojtje nga rreziku.

2. Përpara se të fillojë ndërtimi dhe gjatë procesit të tij ndërmerren hapa të mjaftueshëm për të konstatuar praninë e rrezikut dhe për të siguruar mbrojtjen e punëtorëve nga rreziku nga kabllot e zhveshura elektrike apo aparatet, të cilat janë nën, mbi ose në kantier.

3. Shtrimi dhe mirëmbajtja e kabllave elektrike dhe e aparaturave në kantieret e ndërtimit drejtohen nga rregullat teknike dhe standardet që zbatohen në nivel nacional.

Neni 27

Lëndët plasëse

Lëndët plasëse ruhen, transportohen, trajtohen apo përdoren:

a) vetëm sipas kushteve të përcaktuara nga akte ligjore dhe nënligjore kombëtare; dhe

b) vetëm nga një person kompetent, i cili ndërmerr hapat që janë të nevojshëm për të garantuar që punëtorët dhe personat e tjerë nuk ekspozohen ndaj rrezikut të dëmtimit.

Neni 28

Rreziqet ndaj shëndetit

1. Kur një punëtor është i detyruar të ekspozohet ndaj rrezikut kimik, fizik ose biologjik në atë masë që është e rrezikshme për shëndetin, merren masat e duhura parandaluese ndaj një ekspozimi të tillë.

2. Masat parandaluese, të përmendura në paragrafin 1 më sipër, përbëhen nga:

a) zëvendësimi i substancave të rrezikshme me substanca më pak të dëmshme apo të rrezikshme, kurdoherë që është e mundur; ose

b) masat teknike që zbatohen në fabrikë, makineri, pajisje ose procese; ose

c) kur nuk është i mundur respektimi i nënparagrafëve "a" ose "b" më sipër, masa të tjera efektive, duke përfshirë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse dhe veshjeve mbrojtëse.

3. Kur punëtorëve u kërkohet të hyjnë në një zonë, në të cilën mund të jetë e pranishme një substancë toksike ose e dëmshme apo në të cilën mund të ketë mungesë oksigjeni, apo është një atmosferë e djegshme, merren masat e duhura për mbrojtjen nga rreziku.

4. Mbetjet nuk shkatërrohen apo asgjësohen në një kantier ndërtimi në një mënyrë që rrezikon dëmtimin e shëndetit.

Neni 29

Masat e mbrojtjes nga zjarri

1. Punëdhënësi merr masat e duhura:

a) për të shmangur rrezikun e zjarrit;

b) për të luftuar me shpejtësi dhe në mënyrë efikase çdo shpërthim të zjarrit;

c) për të realizuar një evakuim të shpejtë dhe të sigurt të personave.

2. Për lëngjet, materialet e ngurta dhe gazrat e ndezshme sigurohet ruajtje e përshtatshme.

Neni 30

Pajisjet dhe veshjet personale mbrojtëse

1. Kur nuk mund të sigurohet mbrojtje e mjaftueshme me mjete të tjera kundër rrezikut nga aksidentet apo dëmtimet ndaj shëndetit, duke përfshirë ekspozimin ndaj kushteve të rrezikshme, atëherë, sipas llojit të rrezikut dhe punës, punëdhënësi duhet të sigurojë dhe të ruajë pajisje dhe veshje personale mbrojtëse pa i sjellë asnjë kosto punëtorëve, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare.

2. Punëdhënësi duhet t'u sigurojë punëtorëve mjetet e përshtatshme për t'u mundësuar atyre të përdorin pajisjet mbrojtëse individuale dhe duhet të garantojë përdorimin e duhur të tyre.

3. Pajisjet dhe veshjet mbrojtëse duhet të respektojnë standardet e përcaktuara nga autoriteti kompetent, duke

marrë parasysh sa më shumë që të jetë e mundur, parimet ergonomike.

4. Punëtorët duhet të përdorin siç duhet dhe të tregojnë kujdes për pajisjet dhe veshjet mbrojtëse personale që janë siguruar për përdorim nga ana e tyre.

Neni 31

Ndihma e parë

Punëdhënësi është përgjegjës për të garantuar që ndihma e parë, duke përfshirë personelin e trajnuar, të jetë e disponueshme në çdo kohë. Duhet siguruar kushtet për dërgimin në spital të punëtorëve që pësojnë aksident apo sëmundje të papritur.

Neni 32

Mirëqenia

1. Duhet siguruar sasi e mjaftueshme furnizimi me ujë të pijshëm të shëndetshëm në çdo kantier ndërtimi ose brenda një aksesi të arsyeshëm.

2. Në çdo kantier ndërtimi ose brenda një aksesi të arsyeshëm, në varësi të numrit të punëtorëve dhe kohëzgjatjes së punës, duhen siguruar dhe mirëmbajtur objektet e mëposhtme:

a) objekte sanitare dhe larjeje;

b) objekte për ndërrimin, ruajtjen dhe tharjen e rrobave;

c) objekte për ngrënien e vakteve ushqimore dhe për strehim gjatë ndërprerjes së punës për shkak të kushteve të këqija atmosferike.

3. Duhet siguruar objekte të ndara sanitare dhe larjeje për punëtorët burra dhe gra.

Neni 33

Informacioni dhe trajnimi

Punëtorët duhet:

a) të informohen në mënyrë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për rreziqet ndaj sigurisë dhe shëndetit, ndaj të cilave ata mund të ekspozohen në vendin e tyre të punës;

b) të instruktohen dhe trajnohen në mënyrë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për parandalimin, kontrollin dhe mbrojtjen kundër këtyre rreziqeve.

Neni 34

Raportimi i aksidenteve dhe sëmundjeve

Aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare parashikojnë raportimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në punë pranë autoritetit kompetent brenda një kohe të përcaktuar.

IV. ZBATIMI Neni 35

Të gjithë anëtarët:

a) marrin të gjitha masat, duke përfshirë përcaktimin e sanksioneve të përshtatshme dhe të masave korrigjuese për të garantuar zbatimin efektiv të dispozitave të Konventës;

b) garantojnë shërbimet e duhura të inspektimit për të mbikëqyrur zbatimin e masave që duhet të merren në zbatim të Konventës dhe sigurojnë këto shërbime së bashku me burimet e nevojshme për realizimin e detyrës së tyre ose plotësojnë kërkesat e tyre në lidhje me faktin që është realizuar inspektimi i duhur.

V. DISPOZITA TË FUNDIT Neni 36

Kjo Konventë rishikon dispozitat e Konventës së Sigurisë (Ndërtimit), 1937.

Neni 37

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente i komunikohet drejtorit të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

Neni 38

1. Kjo Konventë është detyruese vetëm për ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, miratimi i të cilëve është regjistruar pranë drejtorit të përgjithshëm.

2. Ajo hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën është bërë regjistrimi i miratimit të dy anëtarëve pranë drejtorit të përgjithshëm.

3. Pas kësaj, kjo kontratë hyn në fuqi për çdo anëtar dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën është regjistruar miratimi i tij.

Neni 39

1. Anëtari, i cili ka miratuar këtë Konventë, mund ta denoncojë atë pas kalimit të një periudhe prej dhjetë vitesh nga data në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi për herë të parë, me anë të një akti që i komunikohet drejtorit të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Një denoncim i tillë nuk hyn në fuqi për një periudhë kohore deri një vit pas datës në të cilën është regjistruar.

2. Çdo anëtar që ka miratuar këtë Konventë dhe që, brenda vitit pas mbarimit të periudhës dhjetëvjeçare të përmendur në paragrafin pararendës, nuk ushtron të drejtën e denoncimit të parashikuar në këtë nen, do t'i nënshtrohet Konventës për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe, për rrjedhojë, mund ta denoncojë këtë Konventë në përfundim të çdo periudhe prej

dhjetë vjetësh në bazë të kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 40

1. Drejtori i përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha miratimeve dhe denoncimeve që i janë komunikuar nga anëtarët e organizatës.

2. Kur njofton anëtarët e Organizatës për regjistrimin e miratimit të dytë që i është komunikuar, drejtori i përgjithshëm u tërheq vëmendjen anëtarëve të organizatës për datën në të cilën hyn në fuqi Konventa.

Neni 41

Drejtori i përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton sekretarin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrimin në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, detajet e plota të të gjitha miratimeve dhe akteve të denoncimit të regjistruara nga ai në përputhje me dispozitat e neneve pararendëse.

Neni 42

Në ato raste që e çmon të nevojshme, organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës i paraqet konferencës së përgjithshme një raport për funksionimin e kësaj Konvente dhe shqyrton dëshirën e vendosjes së rishikimit të pjesshëm apo të plotë të saj në rendin e ditës së konferencës.

Neni 43

1. Nëse konferenca miraton një konventë të re duke rishikuar këtë Konventë tërësisht ose pjesërisht, atëherë, nëse Konventa e re nuk parashikon ndryshe:

a) Miratimi nga një anëtar i Konventës së re rishikuese përfshin *ipso jure* denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, pavarësisht nenit 39 më sipër, nëse hyn në fuqi dhe kur të hyjë në fuqi Konventa e re;

b) Në datën kur hyn në fuqi Konventa e re rishikuese, kjo Konventë nuk është më e hapur për miratim nga anëtarët.

2. Kjo Konventë mbetet në çdo rast në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj faktike për ata anëtarë që e kanë miratuar atë, por që nuk kanë miratuar Konventën rishikuese.

Neni 44

Versionet në gjuhën angleze dhe frënge të tekstit të kësaj Konvente kanë fuqi të njëjtë.

LIGJ
Nr. 6/2014

**PËR RATIFIKIMIN E “TRAKTATIT PËR
TREGTINË E ARMËVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Traktati për tregtinë e armëve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.1.2014

Shpallur me dekretin nr. 8499, datë 18.2.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

A/CONF.217/2013/L.3

Organizata e Kombeve të Bashkuara



Asambleja e Përgjithshme

Shpërnd.: E kufizuar
27 mars 2013
Origjinali: Anglisht

**Konferenca përfundimtare e Kombeve të Bashkuara për
Traktatin për Tregtinë e Armëve**

Nju-Jork, 18 - 28 mars 2013

PROJEKTVENDIM

Dorëzuar nga presidenti i konferencës
përfundimtare

Konferenca përfundimtare e Kombeve të Bashkuara për Traktatin për Tregtinë e Armëve, miraton tekstin e Traktatit për Tregtinë e Armëve, që i është bashkëngjitur këtij vendimi.

SHTOJCA

TRAKTATI PËR TREGTINË E ARMËVE

Parathënie

Shtetet palë të këtij Traktati,

udhëhequr nga qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara,

duke marrë parasysh nenin 26 të Kartës së Kombeve të Bashkuara që kërkon të nxisë vendosjen dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare për burimet njerëzore dhe ekonomike në botë, me devijim sa më të vogël të armatimeve;

duke theksuar nevojën për të parandaluar dhe eliminuar tregtinë e paligjshme të armëve konvencionale dhe për të parandaluar devijimin e tyre në tregun e paligjshëm ose për përdorim fundor, ose te përdoruesit fundorë të paautorizuar, përfshirë kryerjen e akteve terroriste;

duke pranuar interesat legjitime politike të sigurisë, ekonomike dhe tregtare të shteteve në tregtinë ndërkombëtare të armëve konvencionale;

duke riafirmuar të drejtën sovranë të çdo shteti për të rregulluar dhe për të kontrolluar armët konvencionale në mënyrë ekskluzive brenda territorit të tij, sipas sistemit të tij ligjor ose kushtetues;

duke pranuar se paqja dhe siguria, zhvillimi dhe të drejtat e njeriut janë shtyllat e sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe themelet për sigurinë kolektive dhe duke pranuar se zhvillimi, paqja, siguria dhe të drejtat e njeriut janë të ndërlidhura dhe përforcojnë njëra-tjetrën;

duke marrë parasysh udhëzimet e Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Çarmatimin për transferimet ndërkombëtare të armëve në kontekstin e rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 46/36H të datës 6 dhjetor 1991;

duke vërejtur kontributin e dhënë nga programi i Kombeve të Bashkuara i veprimeve për të parandaluar, luftuar dhe asgjësuar tregtinë e paligjshme të armëve të vogla dhe armëve të lehta në të gjitha aspektet, si edhe protokollin kundër prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve të tyre dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, dhe instrumentin ndërkombëtar që u mundëson shteteve të identifikojnë dhe të gjurmojnë, në kohë dhe në mënyrë të besueshme, armët e vogla dhe armët e lehta të paligjshme;

duke pranuar pasojat në siguri, ekonomike dhe humanitare që sjell tregtia e paligjshme dhe e parregulluar e armëve konvencionale;

duke pasur parasysh që civilët, në veçanti, gratë dhe fëmijët, përbëjnë shumicën e atyre që ndikohen në mënyrë negative nga konfliktet e armatosura dhe dhuna e armatosur;

duke pranuar, gjithashtu, sfidat me të cilat përballen viktimat e konfliktit të armatosur dhe nevojat e tyre për kujdesin e duhur dhe rehabilitimin e përfshirjen ekonomike dhe sociale;

duke theksuar se asgjë në këtë traktat nuk i ndalon shtetet që të ruajnë dhe të miratojnë masa efikase shtesë për të zgjeruar objektin dhe qëllimin e këtij traktati;

duke qenë të vetëdijshëm për tregtinë e ligjshme dhe pronësinë e ligjshme dhe përdorimin e armëve të caktuara konvencionale për veprimtari çlodhëse, kulturore,

historike dhe sportive, aty ku një tregti, pronësi dhe përdorim i tillë lejohen ose mbrohen me ligj;

duke qenë, gjithashtu, të vetëdijshëm për rolin që mund të luajnë organizatat rajonale në ndihmën e dhënë për shtetet palë, sipas kërkesës, për zbatimin e këtij Traktati;

duke pranuar rolin vullnetar dhe aktiv që mund të luajë shoqëria civile, përfshirë organizatat joqeveritare dhe industria, në ndërgjegjësimin për objektin dhe qëllimin e këtij Traktati dhe në mbështetjen për zbatimin e tij;

duke pranuar që rregullorja për tregtinë ndërkombëtare të armëve konvencionale dhe për parandalimin e devijimit të tyre nuk duhet të pengojnë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe tregtinë e ligjshme të materialeve, pajisjeve dhe teknologjisë për qëllime paqësore;

duke theksuar dëshirën për të arritur aderim universal në këtë traktat;

të vendosur për të vepruar sipas parimeve të mëposhtme:

Parimet

- E drejta e qenësishme e të gjitha shteteve për vetëmbrojtje individuale ose kolektive, siç njihet në nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare me mjete paqësore në mënyrë të tillë që paqja, siguria dhe drejtësia ndërkombëtare të mos rrezikohen, sipas nenit 2(3) të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

- Vetëpërmbytja në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare për të mos kërcënuar ose përdorur forcën kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të asnjë shteti, ose në ndonjë mënyrë tjetër që nuk pajtohet me qëllimet e Kombeve të Bashkuara, sipas nenit 2(4) të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

- Mosndërrhyrja në çështje që i përkasin kryesisht juridiksionit të brendshëm të secilit shtet, sipas nenit 2(7) të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

- Respektimi dhe garantimi i respektit për të drejtën humanitare ndërkombëtare, në përputhje me, ndër të tjera, Konventën e Gjenevës të vitit 1949, dhe respektimi dhe garantimi i respektit për të drejtat e njeriut në përputhje me, ndër të tjera, Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;

- Përgjegjësia e të gjitha shteteve, në përputhje me detyrimet e tyre ndërkombëtare përkatëse, për të rregulluar me efikasitet tregtinë ndërkombëtare të armëve konvencionale dhe për të parandaluar devijimin e tyre, si edhe përgjegjësia parësore e të gjitha shteteve për të ngritur dhe për të vënë në zbatim sistemet e tyre kombëtare të kontrollit;

- Respektimi i interesave legjitime të shteteve për të blerë armë konvencionale për të ushtruar të drejtën e

tyre për vetëmbrojtje dhe për operacione paqeruajtëse, dhe për të prodhuar, eksportuar, importuar dhe transferuar armë konvencionale;

- Zbatimi i këtij Traktati në një mënyrë të pajtueshme, objektive dhe jodiskriminuese, kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

Objekti i këtij Traktati është:

- përcaktimi i standardeve të përbashkëta ndërkombëtare sa më të larta për rregullimin ose përmirësimin e rregullores për tregtinë ndërkombëtare të armëve konvencionale;

- parandalimi dhe eliminimi i tregtisë së paligjshme të armëve konvencionale dhe parandalimi i devijimit të tyre,

me qëllim:

- kontributin për paqen, sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar dhe rajonal;

- uljen e vuajtjeve njerëzore;

- nxitjen e bashkëpunimit, transparencës dhe veprimit të përgjegjshëm nga shtetet palë në tregtinë ndërkombëtare të armëve konvencionale, duke ndërtuar kështu besim ndërmjet shteteve palë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky Traktat do të zbatohet për të gjitha armët konvencionale të kategorive të mëposhtme:

a) tanket;

b) automjetet e blinduara luftarake;

c) sistemet e artilerisë të kalibrit të madh;

d) avionët luftarakë;

e) helikopterët sulmues;

f) luftanijet;

g) raketat dhe raketahedhëset; dhe

h) armët e vogla dhe armët e lehta.

2. Për qëllimet e këtij Traktati, veprimtaritë e tregtisë ndërkombëtare përfshijnë eksportin, importin, tranzitin, transferimin dhe ndërmjetësimin, në vijim të referuara si "transferim".

3. Ky Traktat nuk zbatohet për lëvizjen ndërkombëtare të armëve konvencionale nga ana, ose në emër të, një shteti palë për përdorimin e tij, me kusht që armët konvencionale të mbeten nën pronësinë e shtetit palë.

Neni 3

Municionet

Çdo shtet palë duhet të krijojë dhe të mirëmbajë një sistem kombëtar kontrolli për të rregulluar eksportin e municioneve që janë shtënë, nxjerrë ose lëshuar nga armët konvencionale që mbulohen në nenin 2(1) dhe

duhet të zbatohet dispozitat e nenit 6 dhe nenit 7 përpara se të autorizojë eksportin e municioneve të tilla.

Neni 4

Pjesët dhe komponentët

Çdo shtet palë duhet të krijojë dhe të mirëmbajë një sistem kombëtar kontrolli për të rregulluar eksportin e pjesëve dhe komponentëve aty ku eksporti bëhet në një formë të tillë që ofron mundësinë për të montuar armët konvencionale që mbulohen nga neni 2(1) dhe duhet të zbatohet dispozitat e nenit 6 dhe nenit 7 përpara se të autorizojë eksportin e këtyre pjesëve dhe komponentëve.

Neni 5

Zbatimi i përgjithshëm

1. Secili nga shtetet palë duhet ta zbatojë këtë Traktat në mënyrë të qëndrueshme, objektive dhe jodiskriminuese, duke pasur parasysh parimet e përmendura në këtë Traktat.

2. Secili shtet palë duhet të krijojë dhe të mirëmbajë një sistem kombëtar kontrolli, përfshirë një listë kombëtare kontrolli, me qëllim zbatimin e dispozitave të këtij Traktati.

3. Secili shtet palë nxitet që t'i zbatojë dispozitat e këtij Traktati për shkallën më të gjerë të armëve konvencionale. Përkufizimet kombëtare të secilës nga kategoritë e përfshira në nenin 2(1)(a)–(g) nuk duhet të mbulojnë më pak se përshkrimet e përdorura në Regjistrin e Kombeve të Bashkuara për Armët Konvencionale në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Traktati. Për kategorinë e mbuluar në nenin 2(1)(h), përkufizimet kombëtare nuk duhet të mbulojnë më pak se përshkrimet e përdorura në instrumentet përkatëse të Kombeve të Bashkuara në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Traktati.

4. Secili shtet palë, në zbatim të ligjeve të tij kombëtare, duhet t'i dorëzojë Sekretariatit listën kombëtare të kontrollit, i cili do t'ia vërë në dispozicion shteteve të tjera palë. Shtetet palë nxiten që listat e tyre të kontrollit t'ia vënë në dispozicion publikut.

5. Secili shtet palë duhet të marrë masat e nevojshme për të zbatuar dispozitat e këtij Traktati dhe duhet të përcaktojë autoritetet kombëtare kompetente për të pasur një sistem kombëtar kontrolli efikas dhe transparent, i cili rregullon transferimin e armëve konvencionale që mbulohen nga neni 2(1) dhe të artikujve të mbuluar nga neni 3 dhe neni 4.

6. Secili shtet palë cakton një ose më shumë pika kontakti kombëtare për të shkëmbyer informacione për çështje që lidhen me zbatimin e këtij Traktati. Secili shtet palë duhet të njoftojë Sekretariatin e ngritur në zbatim të nenit 18, për pikat e kontaktit kombëtare dhe duhet ta mbajë informacionin të përditësuar.

Neni 6

Ndalimet

1. Një shtet palë nuk duhet të autorizojë asnjë transferim të armëve konvencionale sipas nenit 2(1) ose të artikujve të mbuluar nga neni 3 ose neni 4, nëse transferimi përbën shkelje të detyrimeve të tij në zbatim të masave të miratuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që vepron në zbatim të kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, në veçanti embargot e armëve.

2. Një shtet palë nuk duhet të autorizojë asnjë transferim të armëve konvencionale sipas nenit 2(1) ose të artikujve të mbuluar nga neni 3 ose neni 4, nëse transferimi përbën shkelje të detyrimeve të tij ndërkombëtare në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat ai është palë, në veçanti ato që lidhen me transferimin ose trafikimin e paligjshëm të armëve konvencionale.

3. Një shtet palë nuk duhet të autorizojë asnjë transferim të armëve konvencionale sipas nenit 2(1) ose të artikujve të mbuluar nga neni 3 ose neni 4, nëse në kohën e autorizimit ai është në dijeni se armët ose artikujt do të përdoren për kryerje gjenocidi, krimesh kundër njerëzimit, shkelje të rënda të Konventës së Gjenevës 1949, sulme të drejtuara kundër objekteve civile ose civilëve të mbrojtur si të tillë, ose krime të tjera të luftës, siç përkufizohen nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat ky shtet është palë.

Neni 7

Eksporti dhe vlerësimi i eksportit

1. Nëse eksporti nuk ndalohet në zbatim të nenit 6, secili shtet palë eksportues, përpara autorizimit për të eksportuar armët konvencionale të mbuluara nga neni 2(1) ose artikujt e mbuluar nga neni 3 ose neni 4, në juridiksionin e tij dhe sipas sistemit të tij kombëtar të kontrollit, në mënyrë objektive dhe jodiskriminuese, duke marrë në konsideratë faktorët përkatës, përfshirë informacionin e dhënë nga shteti importues në përputhje me nenin 8(1), duhet të vlerësojë mundësinë që armët konvencionale ose artikujt:

a) do të kontribuonin për, ose do të vinin në rrezik paqen dhe sigurinë;

b) mund të përdoren:

i) për të kryer ose ndihmuar në kryerjen e një shkeljeje të rëndë të së drejtës humanitare ndërkombëtare;

ii) për të kryer ose ndihmuar në kryerjen e një shkeljeje të rëndë të ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;

iii) për të kryer ose ndihmuar në kryerjen e një akti që përbën shkelje sipas konventave ose protokolleve ndërkombëtare në lidhje me terrorizmin, në të cilat shteti eksportues është palë; ose

iv) për të kryer ose ndihmuar në kryerjen e një akti që përbën shkelje sipas konventave ose protokolleve ndërkombëtare në lidhje me krimin e organizuar ndërkombëtar, në të cilat shteti eksportues është palë.

2. Shteti palë eksportues, gjithashtu, duhet të marrë në konsideratë nëse ka masa që mund të ndërmerren për të zbutur rreziqet e identifikuar në pikën "a" ose "b" të paragrafit 1, si masat për krijimin e besimit ose programe të zhvilluara dhe të miratuara bashkërisht nga shtetet eksportuese dhe ato importuese.

3. Nëse pas këtij vlerësimi dhe pas marrjes në konsideratë të masave zbutëse të disponueshme shteti palë eksportues vendos se ekziston një rrezik i madh për shfaqjen e ndonjë prej pasojave negative të përmendura në paragrafin 1, shteti palë eksportues nuk do ta autorizojë eksportin.

4. Shteti palë eksportues, gjatë këtij vlerësimi merr parasysh rrezikun që armët konvencionale të mbuluara nga neni 2(1) ose artikujt e mbuluar nga neni 3 ose neni 4 mund të përdoren për të kryer ose për të ndihmuar në kryerjen e akteve të rënda të dhunës me bazë gjinore ose akteve të rënda të dhunës kundër grave dhe fëmijëve.

5. Çdo shtet palë eksportues duhet të marrë masa për të siguruar që të gjitha autorizimet për eksportin e armëve konvencionale të mbuluara nga neni 2(1) ose të artikujve të mbuluar nga neni 3 ose neni 4, të jenë të detajuara dhe të jenë lëshuar përpara eksportit.

6. Çdo shtet palë eksportues duhet t'i vërë në dispozicion informacionet e përshtatshme për autorizimin në fjalë, sipas kërkesës së tij, shtetit anëtar importues dhe shteteve palë të tranzitit ose transferimit, sipas ligjeve, praktikave ose politikave të tij kombëtare.

7. Nëse, pasi është dhënë një autorizim, shteti anëtar eksportues vihet në dijeni të informacioneve të reja të rëndësishme, ai nxitet që ta rivlerësojë autorizimin, pas konsultave, nëse është e përshtatshme, me shtetin importues.

Neni 8 Importi

1. Çdo shtet palë importues duhet të marrë masa për të garantuar dhënien e informacioneve të përshtatshme dhe të rëndësishme, sipas kërkesës, sipas ligjeve të tij kombëtare, shtetit palë eksportues për ta ndihmuar shtetin palë eksportues që të kryejë vlerësimin e tij kombëtar të eksportit në zbatim të nenit 7. Këto masa mund të përfshijnë dokumentacionin për përdorimin ose përdoruesin fundor.

2. Çdo shtet palë importues duhet të marrë masa që i lejojnë atij të rregullojë, aty ku është nevoja, importet në juridiksionin e tij të armëve konvencionale të mbuluara nga neni 2(1). Këto masa mund të përfshijnë sistemet e importit.

3. Çdo shtet palë importues mund të kërkojë informacione nga shteti palë eksportues në lidhje me autorizimet e eksportit të lëna pezull ose ato faktiket, atëherë kur shteti palë importues është shteti i destinacionit përfundimtar.

Neni 9 Tranziti ose transferimi

Çdo shtet palë duhet të marrë masat e përshtatshme për të rregulluar, ku është e nevojshme dhe e përshtatshme, tranzitin ose transferimin në juridiksionin e tij, të armëve konvencionale të mbuluara nga neni 2(1) në të gjithë territorin e tij në përputhje me ligjet ndërkombëtare përkatëse.

Neni 10 Ndërmjetësimi

Çdo shtet palë duhet të marrë masa, në zbatim të ligjeve të tij kombëtare, për të rregulluar ndërmjetësimin që bëhet në juridiksionin e tij për armët konvencionale të mbuluara nga neni 2(1). Masa të tilla mund të përfshijnë kërkesën që ndërmjetësuesit të regjistrohen ose të marrin autorizim me shkrim përpara se të angazhohen në ndërmjetësim.

Neni 11 Devijimi

1. Çdo shtet palë i përfshirë në transferimin e armëve konvencionale të mbuluara nga neni 2(1), duhet të marrë masa për të parandaluar devijimin e tyre.

2. Shteti palë eksportues duhet të përpiqet të parandalojë devijimin e transferimit të armëve konvencionale të mbuluara nga neni 2(1) nëpërmjet sistemit të tij kombëtar të kontrollit, të krijuar sipas nenit 5(2), duke vlerësuar rrezikun e devijimit të eksportit dhe duke marrë në konsideratë përcaktimin e masave zbutëse, të tilla si masat për krijimin e besimit ose programet e zhvilluara dhe të miratuara bashkërisht nga shtetet eksportuese dhe importuese. Masa të tjera parandaluese, aty ku është e përshtatshme, mund të përfshijnë: kontrollin e palëve të përfshira në eksport, kërkesën për dokumentacion shtesë, certifikata, vërtetime, mosautorizimin e eksportit ose masa të tjera të përshtatshme.

3. Shtetet palë të importit, tranzitit, transferimit dhe eksportit duhet të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacione sipas ligjeve të tyre kombëtare, ku është e përshtatshme, me qëllim zbutjen e rrezikut të devijimit të transferimit të armëve konvencionale të mbuluara nga neni 2(1).

4. Nëse një shtet palë zbulon një devijim të armëve konvencionale të transferuara të mbuluara nga neni 2(1), shteti palë duhet të marrë masat e përshtatshme,

sipas ligjeve të tij kombëtare dhe në përputhje me ligjet ndërkombëtare, për të trajtuar një devijim të tillë. Masa të tilla mund të përfshijnë njoftimin e shteteve palë që mund të preken, kontrollin e dërgesave të devijuara të këtyre armëve konvencionale të mbuluara nga neni 2(1) dhe marrjen e masave pasuese nëpërmjet investigimit dhe zbatimit të ligjit.

5. Për të kuptuar sa më mirë dhe për të parandaluar devijimin e armëve konvencionale të transferuara, që mbulohen nga neni 2(1), shtetet palë nxiten që të shkëmbejnë informacionet përkatëse me njëri-tjetrin për masat efikase për të trajtuar devijimin. Këto informacione mund të përfshijnë informacionet për veprimtaritë e paligjshme, përfshirë korrupsionin, rrugët ndërkombëtare të trafikut, ndërmjetësit e paligjshëm, burimet e furnizimit të paligjshëm, metodat e maskimit, pikat e përbashkëta të shpërndarjes ose destinacionet e përdorura nga grupet e organizuara të angazhuara në devijim.

6. Shtetet palë nxiten t'u raportojnë shteteve të tjera palë, nëpërmjet Sekretariatit, për masat e marra për trajtimin e devijimit të armëve konvencionale të transferuara, që mbulohen nga neni 2(1).

Neni 12 Ruajtja e të dhënave

1. Çdo shtet palë duhet të mbajë regjistra kombëtarë, sipas ligjeve dhe rregulloreve të tij kombëtare, për lëshimin e autorizimeve për eksport nga ana e tij ose për eksportet e tij faktike të armëve konvencionale të mbuluara nga neni 2(1).

2. Çdo shtet palë nxitet që të mbajë regjistra për armët konvencionale që mbulohen nga neni 2(1), të cilat transferohen në territorin e tij si destinacion përfundimtar ose që autorizohen të kalojnë tranzit ose të transferohen nëpërmjet territorit që është nën juridiksionin e tij.

3. Çdo shtet palë nxitet që të përfshijë në regjistra: sasinë, vlerën, modelin/llojin, transferimet ndërkombëtare të autorizuara të armëve konvencionale që mbulohen nga neni 2(1), armët konvencionale që janë transferuar faktikisht, detajet e shtetit/eve eksportuese, shtetit/eve importuese, shtetit/eve ku ato kalojnë tranzit ose nëpërmjet të cilave transferohen dhe përdoruesit fundorë, sipas rastit.

4. Regjistrat do të ruhen minimumi për dhjetë vjet.

Neni 13 Raportimi

1. Çdo shtet palë, brenda një viti pas hyrjes në fuqi të këtij Traktati për shtetin palë, sipas nenit 22, duhet të dorëzojë një raport fillestar në Sekretariat për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Traktati, përfshirë ligjet kombëtare, listat kombëtare të kontrollit dhe

rregullore dhe masa të tjera administrative. Çdo shtet palë duhet t'i raportojë Sekretariatit për çdo masë të re të ndërmarrë me qëllim zbatimin e këtij Traktati, kur është e përshtatshme. Raportet u vihen në dispozicion dhe u shpërndahen shteteve palë nga Sekretariati.

2. Shtetet palë nxiten t'u raportojnë shteteve të tjera palë, nëpërmjet Sekretariatit, informacionet për masat e marra që kanë rezultuar efikase për trajtimin e devijimit të armëve konvencionale të transferuara, që mbulohen nga neni 2(1).

3. Çdo shtet palë duhet të dorëzojë çdo vit në Sekretariat, brenda datës 31 mars, një raport për vitin kalendarik pararendës në lidhje me eksportet dhe importet e autorizuara ose faktike të armëve konvencionale që mbulohen në nenin 2(1). Raportet u vihen në dispozicion, u shpërndahen shteteve palë nga Sekretariati. Raporti i dorëzuar në Sekretariat mund të përmbajë të njëjtat informacione që shteti palë ua ka dorëzuar kuadrove përkatës të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Regjistrin e Kombeve të Bashkuara për Armët Konvencionale. Raportet mund të përjashtojnë informacionet sensitive financiare ose informacionet për sigurinë kombëtare.

Neni 14 Zbatimi

Çdo shtet palë duhet të marrë masat përkatëse për të zbatuar ligjet dhe rregulloret kombëtare në zbatim të dispozitave të këtij Traktati.

Neni 15 Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Shtetet palë duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, sipas interesave të tyre përkatëse për sigurinë dhe sipas ligjeve kombëtare, për ta zbatuar Traktatin me efikasitet.

2. Shtetet palë nxiten të ndihmojnë në bashkëpunimin ndërkombëtar, përfshirë shkëmbimin e informacioneve për çështje me interes të përbashkët në lidhje me implementimin dhe zbatimin e këtij Traktati, sipas interesave të tyre përkatëse për sigurinë dhe sipas ligjeve kombëtare.

3. Shtetet palë nxiten të konsultohen për çështje me interes të përbashkët dhe të shkëmbejnë informacione, sipas rastit, për të mbështetur zbatimin e këtij Traktati.

4. Shtetet palë nxiten të bashkëpunojnë, sipas ligjeve të tyre kombëtare, me qëllim për të ndihmuar në zbatimin kombëtar të dispozitave të këtij Traktati, përfshirë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në lidhje me veprimtaritë dhe aktorët e paligjshëm dhe me qëllim parandalimin dhe eliminimin e devijimit të armëve konvencionale që mbulohen nga neni 2(1).

5. Shtetet palë, aty ku bihet dakord bashkërisht dhe në përputhje me ligjet e tyre kombëtare, duhet t'i japin

njëri-tjetrit asistencë maksimale për hetime, ndjekje penale dhe procese gjyqësore në lidhje me shkeljet e masave kombëtare të vendosura sipas këtij Traktati.

6. Shtetet palë nxiten që të marrin masa kombëtare dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të parandaluar që transferimi i armëve konvencionale të mbuluara nga neni 2(1) t'u nënshtrohet praktikave korruptive.

7. Shtetet palë nxiten të shkëmbejnë përvojë dhe informacione për mësimet e nxjerra në lidhje me çdo aspekt të këtij Traktati.

Neni 16

Asistenca ndërkombëtare

1. Për zbatimin e këtij Traktati çdo shtet palë mund të kërkojë asistencë, përfshirë asistencën juridike ose legislative, për ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe asistencë teknike, materiale ose financiare. Kjo asistencë mund të përfshijë programe për menaxhimin e stotope, çarmatimin, demobilizimin dhe riintegrimin, legjislacionin model dhe praktikën efikase për zbatim. Çdo shtet palë në pozita për ta bërë këtë, duhet ta ofrojë një asistencë të tillë sipas kërkesës.

2. Çdo shtet palë mund të kërkojë, të ofrojë ose të marrë asistencë, ndër të tjera, nëpërmjet Kombeve të Bashkuara, organizatave ndërkombëtare, rajonale, nënrajonale ose kombëtare, organizatave joqeveritare ose mbi baza dypalëshe.

3. Shtetet palë që do të ndihmojnë shtetet palë që kërkojnë asistencë ndërkombëtare për zbatimin e këtij Traktati duhet të krijojnë një fond vullnetar besimi. Çdo shtet palë nxitet të kontribuojë me burime për këtë fond.

Neni 17

Konferenca e shteteve palë

1. Sekretariati i përkohshëm, i ngritur në zbatim të nenit 18, organizon një konferencë të shteteve palë jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij Traktati dhe pas kësaj, atëherë kur të vendoset nga konferenca e shteteve palë.

2. Në seancën e saj të parë, konferenca e shteteve palë miraton me konsensus rregullat e procedurës.

3. Konferenca e shteteve palë miraton rregullat financiare për vete, si edhe ato që rregullojnë financimin e çdo organi vartës që mund të ngrejë, si edhe dispozitat financiare që rregullojnë funksionimin e Sekretariatit. Në çdo seancë të zakonshme, ajo miraton një buxhet për periudhën financiare deri në seancën tjetër të zakonshme.

4. Konferenca e shteteve palë:

a) rishikon zbatimin e këtij Traktati, përfshirë zhvillimet në fushën e armëve konvencionale;

b) shqyrton dhe miraton rekomandimet në lidhje me zbatimin dhe vënien në funksionim të këtij Traktati, në veçanti nxitjen e universalitetit të tij;

c) shqyrton ndryshimet e këtij Traktati në përputhje me nenin 20;

d) shqyrton problemet që lindin nga interpretimi i këtij Traktati;

e) shqyrton dhe vendos detyrat dhe buxhetin e Sekretariatit;

f) shqyrton ngritjen e çdo organi vartës, sipas nevojës, për të përmirësuar funksionimin e këtij Traktati; dhe

g) kryen çdo funksion tjetër në pajtim me këtë Traktat.

5. Takimet e jashtëzakonshme të konferencës së shteteve palë mbahen atëherë kur mund të konsiderohen të nevojshme nga konferenca e shteteve palë, ose me kërkesën me shkrim nga çdo shtet palë, nëse kjo kërkesë mbështetet të paktën nga dy të tretat e shteteve palë.

Neni 18

Sekretariati

1. Ky Traktat, me anë të këtij neni ngre një sekretariat për të ndihmuar shtetet palë në zbatimin efikas të këtij Traktati. Në pritje të mbledhjes së parë të konferencës së shteteve palë, përgjegjës për funksionet administrative që mbulohen nga ky Traktat do të jetë një sekretariat i përkohshëm.

2. Sekretariati duhet të ketë staf të kualifikuar. Stafi duhet të ketë ekspertizën e nevojshme për të siguruar që Sekretariati të mund të ndërmarrë me efikasitet përgjegjësitë e përfshira në paragrafin 3.

3. Sekretariati mban përgjegjësi përpara shteteve palë. Brenda një strukture të minimizuar, Sekretariati ndërmerr përgjegjësitë e mëposhtme:

a) merr, vë në dispozicion dhe shpërndan raportet, siç është mandatuar nga ky Traktat;

b) mban dhe vë në dispozicion të shteteve palë listën e pikave kombëtare të kontaktit;

c) lehtëson trajtimin e ofertave dhe të kërkesave për asistencë për zbatimin e Traktatit dhe nxit bashkëpunim kombëtar, sipas kërkesës;

d) lehtëson punën e konferencës së shteteve palë, përfshirë bërjen e rregullimeve dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për takimet në zbatim të këtij Traktati; dhe

e) kryen detyra të tjera, siç vendoset nga konferencat e shteteve palë.

Neni 19

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Shtetet palë konsultohen dhe, me miratim të përbashkët, bashkëpunojnë për të kërkuar zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje që mund të krijohet mes tyre në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Traktati, nëpërmjet negociatave, ndërmjetësimit, pajtimit, zgjidhjeve gjyqësore ose mjeteve të tjera paqësore.

2. Shtetet palë mund të kërkojnë, me miratim të dyanshëm, arbitrazh për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje mes tyre, në lidhje me çështjet që lidhen me interpretimin ose zbatimin e këtij Traktati.

Neni 20
Ndryshimet

1. Gjashtë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Traktati, çdo shtet palë mund të propozojë një ndryshim të këtij Traktati. Më pas, ndryshimet e propozuara mund të merren në konsideratë vetëm nga konferenca e shteteve palë çdo tre vjet.

2. Çdo propozim për të ndryshuar këtë Traktat duhet të dorëzohet me shkrim në Sekretariat, e cila do ta shpërndajë propozimin te të gjitha shtetet palë jo më vonë se 180 ditë përpara mbledhjes së radhës së konferencës së shteteve palë, në të cilën ndryshimet mund të merren në konsideratë sipas paragrafit 1. Ndryshimi merret në konsideratë në konferencën e radhës së shteteve palë, në të cilën ndryshimet mund të merren në konsideratë sipas paragrafit 1, nëse jo më vonë se 120 ditë pas shpërndarjes së tij nga Sekretariati, shumica e shteteve palë njoftojnë Sekretariatit se ata e mbështesin marrjen në konsideratë të këtij propozimi.

3. Shtetet palë duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të arritur konsensus për çdo ndryshim. Nëse janë bërë të gjitha përpjekjet për konsensus dhe nuk është arritur asnjë marrëveshje, si mjet i fundit, ndryshimi miratohet nga një shumicë votash prej tre të katërtat e shteteve palë të pranishme dhe që votojnë në mbledhjen e konferencës së shteteve palë. Për qëllime të këtij neni, shtetet palë të pranishme dhe që votojnë nënkupton shtetet palë të pranishme dhe që hedhin një votë pro ose kundër. Depozituesi ua komunikon të gjitha shteteve palë çdo ndryshim të miratuar.

4. Një ndryshim i miratuar sipas paragrafit 3 hyn në fuqi për çdo shtet palë që ka depozituar instrumentin e tij të pranimit për këtë ndryshim, nëntëdhjetë ditë pas datës kur shumica e shteteve palë ka depozituar te depozituesi instrumentet e pranimit në kohën e miratimit të ndryshimit. Më pas, ai hyn në fuqi për çdo shtet palë që mbetet nëntëdhjetë ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të pranimit të këtij ndryshimi.

Neni 21
Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi

1. Ky traktat është i hapur për nënshkrim në zyrat qendrore të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork nga të gjitha shtetet, nga data 3 qershor 2013 deri sa ai të hyjë në fuqi.

2. Ky traktat i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga secili shtet nënshkrues.

3. Pas hyrjes në fuqi, ky traktat është i hapur për aderimin e çdo shteti që nuk e ka nënshkruar traktatin.

4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen te depozituesi.

Neni 22
Hyrja në fuqi

1. Ky Traktat hyn në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëdhjetë të ratifikimit, pranimit ose miratimit te depozituesi.

2. Për çdo shtet që depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit pas hyrjes në fuqi të këtij Traktati, për atë shtet ky Traktat hyn në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës së dorëzimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 23
Zbatimi i përkohshëm

Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë se ai do t'i zbatojë përkohësisht nenin 6 dhe nenin 7 në pritje të hyrjes në fuqi të këtij Traktati për atë shtet.

Neni 24
Kohëzgjatja dhe tërheqja

1. Ky Traktat ka një kohëzgjatje të pakufizuar.

2. Gjatë ushtrimit të sovranitetit të tij, çdo shtet palë ka të drejtën që të tërhiqet nga ky Traktat. Ai duhet të njoftojë për një tërheqje të tillë depozituesin, i cili njofton të gjitha shtetet e tjera palë. Njoftimi për tërheqje mund të përfshijë një shpjegim të arsyeve për këtë tërheqje. Njoftimi për tërheqje hyn në fuqi nëntëdhjetë ditë pas marrjes së njoftimit për tërheqje nga depozituesi, në rast se njoftimi për tërheqje nuk specifikon një datë të mëvonshme.

3. Tërheqja nga Traktati nuk e çliron shtetin nga detyrimet që dalin nga ky Traktat, ndërkohë që ai ishte palë e këtij Traktati, përfshirë detyrimet financiare që mund të jenë mbledhur.

Neni 25
Vërejtjet

1. Në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, çdo shtet mund të formulojë vërejtje, nëse këto vërejtje nuk bien ndesh me objektin dhe qëllimin e këtij Traktati.

2. Një shtet palë mund ta tërheqë vërejtjen e tij në çdo kohë me anë të një njoftimi për këtë qëllim drejtuar depozituesit.

Neni 26

Lidhja me marrëveshje të tjera ndërkombëtare

1. Zbatimi i këtij Traktati nuk cenon detyrimet e ndërmarra nga shtetet palë në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare ekzistuese ose të ardhshme, në të cilat ata janë palë, kur ato detyrime janë në pajtim me këtë Traktat.

2. Ky Traktat nuk citohet si bazë për shmangie nga marrëveshjet e bashkëpunimit për mbrojtje të lidhura ndërmjet shteteve palë të këtij Traktati.

Neni 27

Depozituesi

Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është depozituesi i këtij Traktati.

Neni 28

Tekstet origjinale

Teksti origjinal i këtij Traktati, nga i cili, tekstet në gjuhët: arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njësoj autentike, depozitohet te sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Nju-Jork, sot më njëzet e tetë mars, dy mijë e trembëdhjetë (28 mars 2013).

LIGJ

Nr. 7/2014

PËR SHPALLJEN E MORATORIUMIT TË GJUETISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përmirësimi i gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.

Neni 2

Objekti dhe fusha e veprimit

Objekti i këtij ligji është ndalimi i ushtrimit të gjuetisë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Pezullimi i lejeve të gjuetisë dhe kontratave

1. Lejet e lëshuara të gjuetisë, si dhe përdorimi i zonave të gjuetisë, të dhëna për këtë qëllim nëpërmjet

ofertës publike, bazuar në ligjin nr. 10 253, datë 11.3.2010, "Për gjuetinë", të ndryshuar, pezullohen.

2. Kontratat për mbarështimin e faunës së egër janë të vlefshme, por edhe në këto zona nuk mund të ushtrohet gjuetia deri në afatin e zbatimit të këtij ligji.

Neni 4

Afati i zbatimit

Afati i zbatimit të këtij ligji është dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 5

Sanksionet

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) kur shkelja kryhet e organizuar nga operatorët e tureve të gjuetisë, shoqatat e gjuetarëve ose federata e gjuetarëve, subjekti që e organizon dënohet me gjobë në masën 800 000 (tetëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë;

b) kur shkelësi është një individ ose është individ, pjesëtar i subjekteve organizuese, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, dënohet me gjobë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe me konfiskim të armës së gjahut.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjes, vendimi i dënimit dhe ankimi kundër tij bëhen në përputhje me ligjin nr. 10235, datë 11.3.2010, "Për gjuetinë", të ndryshuar.

Neni 6

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit

Ngarkohen Ministri i Mjedisit, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Financave dhe Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.1.2014

Shpallur me dekretin nr. 8500, datë 18.2.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 24 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006